

**STANDARD ALBANIAN LANGUAGE AND ITS APPLICATION IN  
ADMINISTRATION  
GJUHA STANDARDE SHQIPE DHE ZBATIMI I SAJ NË  
ADMINISTRATË**

**Hana DARDHISHTA<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: hana.dardhishta@unite.edu.mk*

---

**Abstract**

The Albanian standard language is the asset of our entire nation, regardless of state borders. As for the standard Albanian language in the Republic of North Macedonia, we can say that, although late, today it is being used in educational institutions, in school textbooks, in information tools, in state administration, in politics, in culture, etc. As is known, standard Albanian already functions as a standard language within various administrative and state staff in the Republic of North Macedonia. Until recently, it was used only by the Albanian-speaking community here, but now with the officialization of the Albanian language, its implementation has proven that we encounter problems of a linguistic nature. Starting from these conclusions, at the same time thinking that it would be a topic of interest, I decided to enter the observation and study related to the description of the existing level of use, the implementation of its spelling norms and the functional extension of standard Albanian.

The importance of the correct use of the Albanian language has been discussed in many meetings and discussions, seminars and conferences, also many papers have been published in various scientific journals with the hope of the awareness of our institutions, but also of our society. From the beginning, we must emphasize that this paper or this topic was treated with the desire not to criticize, but to treat it as an issue and at the same time to present some problems related to this issue.

*Keywords: standard language, administration, translation, professional terminology, vocabulary.*

**Përmbledhje**

Gjuha standarde shqipe është pasuri e mbarë kombit tonë, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë. Sa i përket gjuhës standarde shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mund të themi që edhe pse me vonesë, po përdoret në institucionet arsimore, në tekstet shkollore, në mjetet e informimit, në administratë shtetërore, në politikë, në kulturë etj. Siç dihet, gjuha shqipe tashmë funksionon si gjuhë standarde përbrenda kuadrove të ndryshme administrative dhe shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ajo deri vonë përdorej vetëm nga bashkësia shqipfolëse këtu tek ne, por që nga zyrtarizimi i gjuhës shqipe, zbatimi i saj ka dëshmuar se hasim në probleme të karakterit gjuhësor. Duke u nisur nga këto konstatime, njëkohësisht duke menduar që do të ishte temë me interes për gjuhën shqipe, vendosëm që studimi i kësaj trajtese të lidhet si fillim me përshkrimin e nivelit ekzistues të zbatimit të gjuhës dhe të normave të saj drejtshkrimore në institucionet e ndryshme të vendit.

Për rëndësinë e përdorimit të drejtë të gjuhës shqipe është folur në shumë mbledhje e diskutime, seminare e konferenca, gjithashtu janë botuar edhe shumë kumtesa në revista të ndryshme shkencore me shpresë për ndërgjegjësimin e institucioneve tona, por edhe të shoqërisë sonë. Që në fillim duhet të theksojmë se kjo kumtesë apo kjo temë është trajtuar me dëshirën jo për të kritikuar, por për të trajtuar si çështje dhe njëkohësisht për të paraqitur disa problematika lidhur me këtë çështje.

*Fjalë kyçe: gjuhë standarde, administratë, përkthim, terminologji profesionale, fjalor.*

---

## 1. Hyrje

Duke krahasuar rrethanat historike, ku gjuha shqipe ishte gjuhë e ndaluar, më pas me status diskriminues, të pabarabartë e me përdorim tepër të kufizuar, pas kthesës së vitit 2001, me Marrëveshjen e Ohrit dhe me rregullimin ligjor të viteve të fundit, ku lejohet një përdorim më i gjerë dhe paralel i saj, krahas maqedonishtes, tani ka një përdorim më të gjerë të gjuhës shqipe, në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nisur nga këto zhvillime, mund të themi që kemi një status më të avancuar të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht edhe përdorim më të shtuar dhe të gjithanshëm të saj. Nuk dua të ndalem e të trajtoj çështjen mbi realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve këtu tek ne në RMV, por në vijim do të fokusohemi e do ta trajtojmë si çështje përdorimin e gjuhës shqipe në administratë. Pikërisht tani, që gjuha shqipe gjen përdorimin e saj edhe në administratë, shoqëria jonë po ballafaqohet me problematika të natyrave të ndryshme gjuhësore përfshirë këtu edhe standardin e gjuhës.

## 2. Trajtimi i çështjes

Sa i përket procesit të zbatimit të gjuhës shqipe në administratë, përfshirë këtu edhe administratën e gjykatave, zbatim i cili duhej të fillonte para më shumë se një dekadë, që nënkupton se si proces do të kishte përfshirë edhe krijimin e ndërtimin e kapaciteteve kadrovike dhe teknike. Për këtë studim kemi bërë anketë nga individë të ndryshëm që punojnë në institucione të ndryshme të administratës, sidomos nga përkthyesit. Ne jemi marrë me shqyrtimin e gjendjes së gjuhës standarde shqipe, në një prerje të caktuar kohore, pasi që gjuha shqipe ka gjetur përdorimin e saj si gjuhë zyrtare që nga viti 2007 kur edhe bëhet punësimi i shumë përkthyesve në institucionet shtetërore (pas trajnimit të një numri të madh përkthyesish gjatë vitit 2005-2006).

Edhe pse u fillua që atëherë, kjo çështje sikur pati ngecje, dhe tani së voni ka filluar të pranohet dhe të zbatohet nga më shumë institucione shtetërore. Objekti i studimit tonë nuk është përkthimi, por statusi i gjuhës shqipe që sot përdoret në shkresat zyrtare të institucioneve të ndryshme. Për t'i arritur të dhënat që na janë nevojitur për këtë studim, është dashur të përdorim edhe disa shkrime zyrtare të institucioneve tona në vend, gjithashtu kemi marrë edhe tekste nga ueb faqet e institucioneve të ndryshme në vendin tonë, si informata e njoftime të ndryshme, udhëzime administrative etj.

Tekstet e tilla, që janë të stilit administrativ, janë me interes për studimin tonë, meqë ofrojnë një pasqyrë për nivelin e zbatimit të normës në këto shkrime që janë më formale dhe zyrtare. Ç'është e vërteta, korpusi i shkrimeve të këtij lloji është i vogël, por duke pasur parasysh se shkrimet administrative-juridike shpesh rrjedhin prej personave me përgatitje jo të duhur profesionale, nuk mund të shërbejnë si mbështetje. Këto materiale na kanë shërbyer vetëm për t'i regjistruar shembujt dhe për t'i hetuar ato shkelje që janë më karakteristike për të gjitha kategoritë e teksteve të përzgjedhura, pra për t'i hetuar ato shkelje që shfaqen si dukuri. Kryesisht jemi përqëndruar në shkeljet e normës që kanë të bëjnë me rregullat drejtshkrimore si dhe përdorimin e terminologjisë adekuate.


Kemi marrë edhe disa elemente sintaksore që shfaqen si shkelje e normës dhe kryesisht ato që shfaqen si dukuri e përgjithshme, duke mos lënë anash edhe ato raste që do të mund të konsideroheshin si shkelje e normës leksikore. Gjithashtu, qëllimi ynë nuk është që të bëjmë ndonjë vlerësim kritik të atyre punonjësve të institucioneve, tekstet e të cilëve i kemi marrë në vështrim. Në të vërtetë, praktikisht kemi bërë një lloj katalogimi të atyre shkeljeve të normës drejtshkrimore që shfaqen si dukuri në shkrimet e dokumenteve të ndryshme në gjuhën shqipe.

Para se të paraqesim disa shembuj të shkeljes së normës dua të theksoj që cilësia dhe sasia e informimit në gjuhën shqipe (në mënyrë elektronike nga ueb faqet e institucioneve) mund të vërehet që nga korniza për navigim të shpejtë, ku në gjuhën shqipe ka më pak kategori informimi, në disa raste kategoritë ekzistojnë, por brenda tyre nuk ka as edhe një dokument të vetëm në gjuhën shqipe e në disa raste titulli ekziston në gjuhën shqipe, por dokumenti që hapet është në gjuhën maqedonase që dë të thotë titulli (si vegëz) është i përkthyer ndërsa teksti jo (duke e ditur që sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve<sup>70</sup> i bie që qytetarët kanë të drejtën e tyre të garantuar me ligj që të parashtrajnë ankesa, padi, parashtrësia etj. në gjuhën shqipe, njëkohësisht kanë të drejtë edhe të njoftohen apo të informohen rreth procedurave apo edhe rreth diçkaje më parësore siç është orari i punës së një institucioni, e të cilën për fat të keq e gjen vetëm në gjuhën maqedonase)<sup>71</sup>.

- Norma drejtshkrimore në shkrimet zyrtare institucionale: në vijim po i paraqesim disa shkelje të normës që i kemi identifikuar nga tekste të dokumenteve të ndryshme, si:

1. Shkelje të normës së drejtëshkrimit të zanoreve, si p.sh.:

- Fjalë që shkruhet me y dhe jo me u, si në shembullin në vijim: *salla e gjukimeve* (duhet: gjykimeve), në vijim kemi edhe ilustrimin<sup>72</sup>



Ilustrimi 1

2. Shkelje të normës së drejtëshkrimit të bashkëtingëlloreve, si p.sh.:

- Fjalë që shkruhen me r dhe jo me rr: *...dhe masa të tjera për rruajtjen e mjeteve të punës dhe të...*<sup>73</sup> (duhet: ruajtjen); apo shembulli si: *...të gjitha hapësirat doemos të kenë çelësa rezerva të cilat rruhen tek policia gjyqësore...* (duhet: ruhen); sqarim për foljen: rruaj (p.sh. rruaj mjekrën, por ruaj shtëpinë, pra kemi të bëjmë me dy folje të ndryshme);
- Në shembujt në vijim kemi të kundërtën, fjalë që shkruhen me rr dhe jo me r: *reziqet e punës*<sup>74</sup> (duhet: rreziqet e punës).

3. Përdorimi i shkronjave të mëdha, si p. sh.:

- Sipas drejtëshkrimit të gjuhës shqipe, emërtimet e funksioneve shtetërore, politike e ushtarake, të gradave, të titujve fetarë etj. shkruhen me shkronjë të vogël, ndërsa në shembullin në vijim, siç duket nga ndikimi i gjuhës maqedonase kemi: *"Fotografimi, audio dhe video incizimi në ndërtesën gjyqësore mund të bëhet vetëm me lejen me shkrim nga Kryetari i Gjykatës"*<sup>75</sup> (origjinali: *фотографирање, аудио*

<sup>70</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/2019.

<sup>71</sup> sud.mk (Gjykata themelore penale Shkup).

<sup>72</sup> Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata themelore penale Shkup, Kalendari i gjykatës.


<sup>73</sup> Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (origjinali: Куќен ред бр. 868/21 од 19.11.2021 година; përkthyer: Rend shtëpiak), neni 6, paragrafi 3.

<sup>74</sup> Po aty, neni 1, paragrafi 1.

<sup>75</sup> Po aty, neni 15.

и видео снимање, во судската зграда, може да се врши само со писмено одобрение од Претседателот на Судот).

4. Shkeljet e normës drejtshkrimore në fushën e përemrave, si:
  - Një shkelje tjetër vërehet në përdorimin e trajtave të shkurtra të përemrave, të cilat përdoren pa apostrof. Norma me patjetër duhet respektuar dhe asesi nuk guxon që trajta e shkurtër të shkruhet si në shembullin e dhënë nga dokumentet e administratës së gjykatave. Po japim disa shembuj<sup>76</sup> për ilustrim: ...në afat kohor synon që ti identifikon... (duhet: t'i); apo shembulli tjetër, si: *Aktet ua dërgojmë në gjuhën maqedonase, ndërsa pasi të kryhet përkthimi nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe, do të ua dërgojmë menjëherë* (duhet: t'ua).
5. Shkeljet e normës drejtshkrimore në fushën e emrave, si:
  - Një prej shkeljeve që shfaqet si dukuri e shpeshtë ndodh kur emrat në shumës shkruhen pa ë. Shkruhet me ë fundore, në rastin konkret emri i gjinisë femërore, në shumës, dhe jo si në shembullin në vijim: *Të bëhet njohja e personit mbi fotografit e kërkesës*<sup>77</sup> (duhet: fotografitë).
6. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes.
  - Shkruhen njësh të gjitha ato njësi që nga pikëpamja leksikore përbëjnë një fjalë të vetme, dhe jo si në rastin konkret, si: ...*për pasaportë dhe letër njoftim të personave të dyshuar të cilët do t'i paraqiten për njohje letërnjoftim*);



Ilustrimi 2

7. Herë pas here do të rasisim në përdorimin e një shqipe kryesisht të përkthyer nga maqedonishtja, me fjalën shqipe po me mënyrën e të menduarit dhe me krijime njësisish sintaksore tepër shpesh në frymën e maqedonishtes si gjuhë zyrtare, si:
  - *"Të punësuarit janë të obliguar që para lëshimit të hapësirave punuese t'i kontrollojnë nëse janë dritaret e mbyllura, dritat e kyçura, mjetet dhe aparatet elektrike"*<sup>79</sup> (origjinali: *Вработените се должни*

<sup>76</sup> www.vsrn.mk (Politika e kualitetit)

<sup>77</sup> Shembullin e kemi te Ilustrimi 2.


<sup>78</sup> Po aty,

<sup>79</sup> Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (po aty, neni 7, paragrafi 1).

пред напуштањето на работните простории да проверуваат дали се затворени проzorците, угасnати светлата, електричните уреди и апарати). Nga fjalia e mësipërme mund të konstatojmë që, përveç gabimeve në përkthim (...dritat e kuçura... duhet: dritat e fikura) konteksti i fjalisë nuk është i qartë, pra fjalia ka një përmbajtje apo shpjegim të paqartë, apo më mirë thënë është e vështirë të kapet a të kuptohet pa e lexuar origjinalin. Në vijim kemi edhe një shembull tjetër:

- "Pjesëtarët e policisë gjyqësore pas orarit të punës obligohen të bëjnë kontroll të rregullt të hapësirave dhe të gjendjes në dhe rreth ndërtesës gjyqësore"<sup>80</sup> (origjinali: Припадниците на судската полиција по работното време се должни да вршат редовна контрола на просториите и состојбата во и околу судската зграда), duhet: ...brenda dhe jashtë ...

8. Shkelja e radhës ka të bëjë me përdorimin e fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe, si:
  - Fjalën «квалитет» që është në gjuhën maqedonase, shpesh herë e gjejmë edhe në tekstet e gjuhës shqipe, si në shembullin në vijim: "Politika e kualitetit"<sup>81</sup>, për këtë fjalë e kemi fjalën shqipe «cilësi».
9. Deri vonë në shumë shkresa e njoftime, të cilat adresoheshin për institucione të ndryshme apo edhe për individë të ndryshëm, adresimi bëhej në këtë mënyrë: *Deri te: Fakulteti filologjik*, kjo nga maqedonishtja, si: До: Филолошки факултет. Përveç gabimit drejtshkrimor, në shembullin e mësipërm, konstatojmë se gjuha shqipe nuk e ka në natyrën e saj as të thuhet e aq më pak të shkruhet *Deri te*. Nga vërejtjet e shumta që adresoheshin në këtë drejtim, tani së fundmi në disa institucione është bërë korrigjimi me fjalën *Dërguar*, që, sipas mendimit tim, do të duhej të ishte *Drejtuar* ose *Për*<sup>82</sup>. Këtë më së miri e shohim te ilustrimi në vijim:



Ilustrimi 3

<sup>80</sup> Po aty, neni 7, paragrafi 2.

<sup>81</sup> www.vsrn.mk

<sup>82</sup> Shembull që shumë lehtë mund të dëshmohet edhe nga individë të ndryshëm të cilët i janë drejtuar ndonjë institucioni shtetëror. Gjithashtu, këtë mund ta dëshmoj edhe nga përvoja ime e punës në administratë.

Këto shembuj e shumë shembuj të tjerë na tregojnë që gjuha shqipe e shkruar është në trysni të vazhdueshme nga maqedonishtja, dhe se pasojat e gjithë kësaj situate do të jenë të shumta, disa sosh i zënë frymën shqipes standarde që përdoret këtu tek ne. Në kushtet kur tani më gjuha shqipe është një gjuhë zyrtare e dytë dhe ku si burime informacionesh nga më të ndryshmet, si nga fusha politike, ekonomike apo edhe kulturore etj. shërben një gjuhë tjetër, në rastin konkret maqedonishtja, po ndodh një dukuri e dëmshme për gjuhën shqipe: shqipja standarde, sidomos në fushë të sintaksës, po shfityrohet shumë, për të përfunduar në shumë elemente, si një gjuhë e përkthyer (sidomos për gjuhën shqipe të shkruar).

Në faqet e mësipërme u munduam që t'i paraqesim me radhë disa shkelje të normës drejtshkrimore në shkrimet e institucioneve. Kjo ka pasur për qëllim që përmes këtij shkrimi të ofrohet një pasqyrë sa më e përafërt e shkallës së përvetësimit të gjuhës standarde të shkruar në administratë në vendin tonë dhe për t'i hetuar ato elemente të normës drejtshkrimore dhe gramatikore në të cilat mund të vërehen shkeljet e normës nga përdoruesit e saj. Në paraqitjen e mësipërme të këtyre shkeljeve e pamë që gabimet në përdorimin e normës drejtshkrimore hasen në të gjitha sistemet e gjuhës: në sistemin fonologjik, leksikor, gramatikor dhe sintaksor. Këto shkelje do të thoja që kanë karakter individual dhe dalin nga më të ndryshmet, duke prekur të gjitha nënsistemet e gjuhës së standardizuar, por që shkeljet më serioze të normës shfaqen në fushën e sintaksës.

#### 4. Përfundime

Si përfundim, ne si shoqëri duhet të bëjmë një përpjekje këmbëngulëse, e ngritur në shkallë institucionale, për të zotëruar natyrën apo frymën e shqipes dhe kjo në radhë të parë duke bërë demaqedonizimin e shqipes, sepse për mendimin tim gjuha shqipe e shkruar në dokumente të ndryshme të administratës, pa asnjë dyshim, më së shumti lëngon nga modele njësisht sintaksore nga gjuha maqedonase si gjuhë zyrtare. Kjo situatë bëhet më e vështirë për brezat e rinj, sepse modele të tilla të të shprehurit ata i nxënë sikur të ishin tipike për standardin. Objekt kryesor mbetet mënjanimi i fjalëve të huaja të panevojshme, zbatimi i gjuhës standarde shqipe dhe krahas kësaj ruajtja e natyrës së gjuhës shqipe në fushën e ndërtimeve sintaksore. Ne jemi të bindur se në një trajtesë si kjo nuk mund të përmbliiden të gjitha shembujt, e bashkë me to e gjithë çështja që ka të bëjë me gjuhën standarde shqipe dhe zbatimin e saj në administratë, por jemi përpjekur të konkretizojmë se cilat janë sfidat me të cilat ne përballemi.

Në përmbyllje, megjithatë do të shtoja edhe këtë, që gjuha jo vetëm që nuk shkruhet gjithnjë mirë e më mirë, por ka kaluar në diçka dytësore, sikur ka harresë për t'u marrë me të. Nuk duhet harruar që ruajtja e pastërtisë së gjuhës amtare është detyrë e çdonjërit që është pjesë e një shoqërie

#### Referencat

- [1]. *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1983.
- [2]. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [3]. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, numër 7/2019.
- [4]. Lafe E., Caka N., Duro A., Rizaj M., punim studimor *Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-shkencës*, nr. 3-4, Shkup, 2014.
- [5]. Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
- [6]. Lloshi, Xhevat, *Shkrime rreth përkthimit*, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020.
- [7]. Lloshi, Xhevat, *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike*, Onufri, Tiranë, 2011.
- [8]. Murati, Qemal, *Shqipja standarde të mbrohet me ligj*”, Instituti Albanologjik – Prishtinë, “Gjuha shqipe viti XXXIII”, Prishtinë, 2015.
- [9]. Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, 2017.
- [10]. [www.sud.mk](http://www.sud.mk)
- [11]. [www.vsrn.mk](http://www.vsrn.mk)
- [12]. [www.mon.gov.mk](http://www.mon.gov.mk)
- [13]. [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)
- [14]. [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk)